- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i kontratës,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3937 Nr. i faq/Br.str/No.pg 97

Data/Datum/Date 06 / 3 / 24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të prokurimit publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik, nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave në projektin **“Renovimi i objektit të vjetër të QKMF- së në Rahovec – FAZA E DYTË”**, me Nr. Prokurimi: 623-24-1681-5-3-5, me Nr. të brendshëm: 623-23-029-5-2-1/5, të datës 5.3.2024, në përbërje prej:

- 1.1. Egzon Thaqi, kryesues,
- 1.2. Vjollca Berisha, anëtare,
- 1.3. Enise Dina, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të tenderit për projektin **“Renovimi i objektit të vjetër të QKMF- së në Rahovec – FAZA E DYTË”**.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Këshillit Organizues të Festivalit Tradicional Folklorik "Anadrinia Jehon 2024"

1. **Caktohet** Këshilli Organizues i edicionit të 23-të të Festivalit Tradicional Folklorik "Anadrinia Jehon 2024", në këtë përbërje:
 - 1.1. Afrim Dina, kryesues,
 - 1.2. Muharem Morina, anëtar,
 - 1.3. Shadat Ukaj, anëtar,
 - 1.4. Bajram Morina, anëtar,
 - 1.5. Salih Bytyqi, anëtar,
 - 1.6. Fatmir Hoti, anëtar,
 - 1.7. Qemajl Krasniqi, anëtar,
 - 1.8. Daut Bytyqi, anëtar,
 - 1.9. Naser Dula, anëtar,
 - 1.10. Afrim Berisha, anëtar,
 - 1.11. Feriz Thaqi, anëtar,
 - 1.12. Qerim Hoti, anëtar,
 - 1.13. Saranda Sallteku, anëtare,
 - 1.14. Diellza Çanta, anëtare,
 - 1.15. Nora Boshnjaku, anëtare,
 - 1.16. Gani Bytyqi, anëtar,
 - 1.17. Dervish Çadraku, anëtar,
 - 1.18. Dafina Gashi, anëtare,
 - 1.19. Besnik Hoti, anëtar.
2. Këshilli ka për detyrë të ndërmarrë të gjitha veprimet organizative për mbarëvajtjen e festivalit, përfshirë seleksionimin e grupeve artistike pjesëmarrëse në festival, rregullimin e skenës, përzgjedhjen e jurisë profesionale për vlerësim, shpërndarjen e ftesave për pjesëmarrësit, si dhe ndarjen e çmimeve të festivalit në natën finale.

3. Obligohet këshilli që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Organizimi dhe ndarja e përgjegjësiave për pjesën operative të organizimit të festivalit i takon kryesuesit të këshillit organizues.
5. Këshilli organizues është i obliguar që t'i raportojë Kryetarit të Komunës mbi ecurinë, mbarëvajtjen dhe shpenzimet e organizimit të festivalit.
6. Këshilli do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat të arsyeshëm.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e këshillit organizues dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
8. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Anëtarët e këshillit organizues,*
- *Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “Furnizimi dhe rregullimi i xhamave në shkolla”, me numër të kontratës: 623-24-841-1-3-6/C560, si në vijim:
 - 1.1. Admirim Durguti, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për paga dhe shpenzime në Drejtorinë e Arsimit, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Avni Morina, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë kontratën, barten nga zyra e prokurimit tek menaxheri i kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i kontratës, duhet të kyçet në

Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të Kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi/mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të Kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me operatorin ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblertjen;
 - 4.4. Pas pranimi të urdhërblertjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblertjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga data e cila fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamenti të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimi të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamenti të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës janë:
- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Spektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine

Municipal Mayor

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINETI PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3958 Nr. i faq./Br.su./No.pg 99

Data/Datum/Date 11/3/24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 8 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të dhe shoqatat në fushën e rinisë dhe të sportit mbi bazën e thirrjes publike

- Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të dhe shoqatat në fushën e rinisë dhe të sportit për vitin 2024, në këtë përbërje:
 - 1.1. Qemajl Krasniqi, kryesues,
 - 1.2. Egzon Thaqi, anëtar,
 - 1.3. Vlora Reshiti, anëtare,
 - 1.4. Taulant Haxhimustafa, anëtar (ekspert i jashtëm),
 - 1.5. Lulzim Kadiri, anëtar (përfaqësues nga OJQ – ekspert i jashtëm),
 - 1.6. Arsim Kastrati, anëtar rezervë.
- Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të dhe shoqatat në fushën e rinisë dhe të sportit, mbi bazën e thirrjes publike, me Nr. Prot. 516, të datës 16.2.2024 dhe në përputhje me Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
- Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe duke u bazuar në thirrjen publike me Nr. Prot. 516, të datës 16.2.2024.
- Komisioni do të fillojë punën në datën 12.3.2024 dhe ka mandat deri në përfundimin e procedurës së shpalljes së përfituesve, sipas Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- DKRS-së, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI / KAVETARIT TË KOMUNES / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3959 Nr. i faq/Br.str/No.pg 99
Data/Datum/Date 11 / 3 / 24
PRAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 8 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të dhe shoqatat në fushën e kulturës mbi bazën e thirrjes publike

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të dhe shoqatat në fushën e kulturës për vitin 2024, në këtë përbërje:
 - 1.1. Shadat Ukaj, kryesues,
 - 1.2. Muharem Morina, anëtar,
 - 1.3. Ardian Rama, anëtar,
 - 1.4. Blerta Hasani, anëtare (eksperte e jashtme),
 - 1.5. Almedina Jaha, anëtare (përfaqësuese nga OJQ – eksperte e jashtme),
 - 1.6. Tefik Krasniqi, anëtar rezervë.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të dhe shoqatat në fushën e kulturës, mbi bazën e thirrjes publike me Nr. Prot. 516, të datës 16.2.2024 dhe në përputhje me Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe duke u bazuar në thirrjen publike me Nr. Prot. 516, të datës 16.2.2024.
4. Komisioni do të fillojë punën në datën 12.3.2024 dhe ka mandat deri në përfundimin e procedurës së shpalljes së përfituesve, sipas Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- DKRS-së, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3968 Nr. i faq/Br.str/No.pg 100

Data/Datum/Date 12 / 3 / 24

RAHOVEC, ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), në nenin 40 të Ligjit Nr. 08L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 20 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

- Formohet Komisioni i Rekrutimit për të zhvilluar procedurën e pranimin në punë të një Specialisti të Ekonomisë, sipas Konkursit RN00013243, për pozitën: Zyrtar për Taksë Komunale, në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim, në këtë përbërje:
 - Agron Thaqi, kryesues,
 - Ekrem Bytyqi, zëvendësues,
 - Asllan Mazreku, anëtar,
 - Saranda Shala, zëvendësuese,
 - Kapllan Gashi, anëtar,
 - Shqipe Tara, zëvendësuese,
 - Isak Hoti, anëtar,
 - Mirsad Shala, zëvendësues,
 - Fidan Hoti, anëtar,
 - Artan Asllani, zëvendësues.
- Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 08L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
- Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Komisioni,
- Udhëheqësi i Personelit, dhe
- Arkivi.






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 36 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 1/2023"), nenit 7, paragrafi 2 dhe paragrafi 4, i Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

- Me këtë vendim **AUTORIZOHEN** zyrtarët e Komunës së Rahovecit, që të punojë jashtë orarit të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavëve, të cilët janë pjesë e komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mira materiale nga ndikimi i fatkeqësive natyrore dhe i fatkeqësive të tjera, si në vijim:
 - 1.1. Artan Asllani,
 - 1.2. Vlora Nazifi-Gashi, dhe
 - 1.3. Beqir Hamza.
- Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi, kanë të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës dhe atë 30% në orë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe 50% në orë për punën gjatë fundjavëve dhe festave zyrtare, nga data 1.4.2024, deri më datë 31.5.2024.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe prodhon efekt juridik deri në revokimin e tij.

A r s y e t i m

Me vendimin me Nr. Prot. 02/178, të datës 15.2.2023, është caktuar komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mira materiale nga ndikimi i fatkeqësive natyrore dhe i fatkeqësive të tjera, i cili është formuar për vlerësimin e fatkeqësive natyrore në Komunën e Rahovecit, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera dhe Rregulloren (QRK) – Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera.

Andaj, duke marrë parasysh se komisioni duhet të punojë edhe jashtë orarit të rregullt të punës, me qëllim vlerësimi dhe përgatitjeje të raportit përfundimtar, siç parashihet me legjislacionin në fuqi, të lartpërmendurit janë të detyruar që të punojnë edhe jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës, gjatë fundjavëve dhe festave zyrtare dhe për këtë arsye, të lartpërmendurit kanë të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës dhe atë 30% në orë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe 50% në orë për punën gjatë fundjavëve dhe festave zyrtare, sipas legjislacionit në fuqi dhe atë nga data 1.4.2024, deri më datë 31.5.2024.

Kompensimi i anëtarëve të lartpërmendur bazohet në nenin 10, paragrafi 3 i Rregullores (QRK) – Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, në të cilën parashihet se për punën e vet, komisioni kompensohet.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Me vendim të njoftohen:

- *Të lartpërmendurit,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
- *Njësia e Personelit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011"), dispozitave të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kontratës me titull "Lot 2 – Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike të Rahovecit", me numër të kontratës: 623-21-4146-5-1-1/C324, kërkesës dhe rekomandimit të menaxherit të kontratës me Nr. Prot. 196, e datës 24.1.2024, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në kontratën me titull "Lot 2 – Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike të Rahovecit"

1. Me këtë vendim **lejohe**t ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve të situacionit nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull "Lot 2 – Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike të Rahovecit", me numër të kontratës: 623-21-4146-5-1-1/C324.
2. Ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të bëhet nga pozicionet e kontratës: TABELA B – Poz: 1.1, 1.2, 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 4.1, 4.2, 4.3, 4.4, 4.5, 5.1, 5.2, 5.3, 5.4, 5.5, 5.6 dhe 5.7; TABELA C – Poz: 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 2.1, 2.1, 3.1, 3.1, 4.1, 4.2, 4.3, 5.1, 5.2, 5.2, 5.2, 6.1, 6.2, 6.3, 6.4, 7.1, 7.2, 7.3, 7.4, 7.5, 8.1, 8.2, 8.3, 9.1, 9.2 dhe 9.3; TABELA C-1 – Poz: 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.11, 1.12, 1.13, 1.14 dhe 1.15; TABELA C-2 – Poz: 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.11, 1.12, 1.13, 1.14, 1.15, 1.16, 1.17, 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7, 2.8, 2.9, 2.10, 2.11, 2.12, 2.13, 2.14, 2.15, 2.16, 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4; TABELA D – Poz: 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.11, 1.12, 1.13 dhe 1.14 në pozicionet e domosdoshme për realizim: TABELA A - Poz. 2.2, 3.7, 5.2 dhe 5.3, pa implikime financiare shtesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Prokurimit, menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Ofruesi i shërbimeve (punëkryesi), i kontratës me titull "Lot 2 – Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike të Rahovecit", me numër të kontratës: 623-21-4146-5-1-1/C324, i ka rekomanduar menaxherit të kontratës, me kërkesën e datës 6.3.2024, ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në këtë kontratë, me qëllim të përfundimit të këtij projekti.

Pas kësaj, menaxheri i kontratës, përmes mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, ka parashtruar kërkesën me Nr. Prot. 831, të datës 11.3.2024, me anë të së cilës ka kërkuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull “Lot 2 – Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike të Rahovecit”, me numër të kontratës: 623-21-4146-5-1-1/C324 dhe atë nga pozicionet e kontratës: TABELA B – Poz: 1.1, 1.2, 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 4.1, 4.2, 4.3, 4.4, 4.5, 5.1, 5.2, 5.3, 5.4, 5.5, 5.6 dhe 5.7; TABELA C – Poz: 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 2.1, 2.1, 3.1, 3.1, 4.1, 4.2, 4.3, 5.1, 5.2, 5.2, 5.2, 6.1, 6.2, 6.3, 6.4, 7.1, 7.2, 7.3, 7.4, 7.5, 8.1, 8.2, 8.3, 9.1, 9.2 dhe 9.3; TABELA C-1 – Poz: 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.11, 1.12, 1.13, 1.14 dhe 1.15; TABELA C-2 – Poz: 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.11, 1.12, 1.13, 1.14, 1.15, 1.16, 1.17, 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7, 2.8, 2.9, 2.10, 2.11, 2.12, 2.13, 2.14, 2.15, 2.16, 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4; TABELA D – Poz: 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.11, 1.12, 1.13 dhe 1.14 në pozicionet e domosdoshme për realizim: TABELA A - Poz. 2.2, 3.7, 5.2 dhe 5.3, pa implikime financiare shtesë.

Ky ndërrim (kolaodim) i pozicioneve është bërë me qëllim të përfundimit të projektit, me të cilin është rënë dakord me operatorin ekonomik dhe me menaxherin e kontratës dhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, që të bëhet pa implikime financiare.

Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit, menaxherin e kontratës dhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndërrim të pozicioneve në kontratën e lartpërmendur.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- *Menaxherit të kontratës,*
- *Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë,*
- *Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,*
- *Zyrës së Prokurimit, dhe*
- *Arkivit.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3975 Nr. i faq./Br.str./No.pg 101
Data/Datum/Date 14/3/24
RAHOVEC/ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për rivlerësimin e ofertave

- 1. Caktohet** komisioni për rivlerësimin e ofertave për projektin: “Furnizim me pelet për nevojat e komunës së Rahovecit, për vitin 2023/2024”, me Nr. prokurimi: 623-23-13234-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-078-1-2-1, në këtë përbërje:
 - 1.1.** Faik Thaqi, kryesues,
 - 1.2.** Vjollca Berisha, anëtare,
 - 1.3.** Egzon Thaqi, anëtar.
- Komisioni ka për detyrë të bëjë rivlerësimin e ofertave për projektin “Furnizim me pelet për nevojat e komunës së Rahovecit, për vitin 2023/2024”, me Nr. prokurimi: 623-23-13234-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-078-1-2-1 .
- Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.


Smail Latifi

Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Ndërhyrjet në rastet emergjente infrastrukturore", me numër të kontratës: 623-24-604-2-2-1/C559, si në vijim:
 - 1.1. "P.M.N." Sh.p.k., me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Përparim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e menaxherit të projektit/kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e autoritetit kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termet dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e menaxherit të projektit/kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës

nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me operatorin ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të menaxhimit të kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblenjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërblenjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblenjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që autoriteti kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
 - 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Spektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET / PRESIDIKU OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No 3977	Nr. i faq./Br.str./No.pg 101
Data/Datumi/Date 14/3/24	
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Rrënimi i objekteve pa leje", me numër të kontratës: 623-24-435-5-2-1/C557, si në vijim:
 - 1.1. "P.M.N." Sh.p.k., me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Nora Boshnjaku, drejtore e Drejtorisë për Inspektim, **CAKTOHET** mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e menaxherit të projektit/kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e autoritetit kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e menaxherit të projektit/kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, menaxheri i kontratës

- brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";
- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me operatorin ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërbljerjen;
 - 4.4. Pas pranimi të urdhërbljerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërbljerjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që autoriteti kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimi të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Sektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Preşednik Opštine – Municipal Mayor

	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 3978 Nr. i faq./Br.str./No.pg 101		
Data/Datum/Date 14 / 3 / 2017		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.03.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të punëve, sipas kontratës

1. **Caktohet** komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të punëve, sipas kontratës me titull "Grumbullimi i mbeturinave dhe mirëmbajtja e rrugëve gjatë dy sezoneve – Lot 2" me nr. të prokurimit: 623-23-13129-2-1-1/C546, në përbërje prej:
 - 1.1. Bjondina Ramaj, kryesuese,
 - 1.2. Metush Isma, anëtar,
 - 1.3. Egzon Thaqi, anëtar.
2. Komisioni, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të punëve të kryera nga operatori ekonomik, sipas specifikacioneve të kontratës, mbikëqyrjen e realizimit të punëve në terren, mbikëqyrjen e raporteve dhe të specifikacioneve të menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, si dhe punë të tjera që kanë të bëjnë me këtë kontratë.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në kontratën me titull "Grumbullimi i mbeturinave dhe mirëmbajtja e rrugëve gjatë dy sezoneve – Lot 2" me nr. të prokurimit: 623-23-13129-2-1-1/C546.
4. Obligohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës që, nënshkrimin e raporteve, të specifikacioneve të kontratës dhe pranimin e punëve të kryera ta bëjë vetëm pas verifikimit paraprak të tyre nga ky komision.
5. Obligohet komisioni që të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës çdo 1 (një) muaj.

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Shërbime Publike në Komunën e Rahovecit.
7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me Nr.Prot.02/ 3845/2024, i datës 14.2.2024.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

1. *Anëtarëve të komisionit,*
2. *Menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë,*
3. *Drejtorisë për Shërbime Publike,*
4. *Arkivit.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESDESIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3979 Nr. i faq./Br.str./No.pg 101

Data/Datum/Date 14 / 3 / 24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **APROVOHET** kërkesa me Nr 856, e datës 13.3.2024, e SHL-KOSOVA, dhe i lejohet furnizimi me derivate të naftës, në sasi prej 90 L (nëntëdhjetë litra), për të mbuluar shpenzimet e transportit për autobusin e Qendrës Rinore SHL-Kosova, të artistëve nga Prishtina në Rahovec, të Fondacionit koncertal “ARSKOSOVA”, të cilët do të shfaqin koncert në Rahovec me 15 mars 2024.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U dërgohet :

- *SHL- Kosova,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe*
- *Arkivit.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3980 Nr. i faq./Br.str./No.pg 101

Data/Datum/Date 14/3/24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **APROVOHET** kërkesa me Nr 892, e datës 14.3.2024, e KF Anadrini, dhe i lejohet furnizimi me derivate të naftës, në sasi prej 40 L (katërdhjetë litra), për transportimin e artistëve nga Prishtina në Rahovec, të Fondacionit koncertal “ ARSKOSOVA”, të cilët do të shfaqin koncert në Rahovec me 15 mars 2024.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U dërgohet :

- *KF Anadrini-Ratkoc,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe*
- *Arkivit.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr. 03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 40 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 20 të Rregullores (QRK) nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

- Formohet Komisioni i Rekrutimit për të zhvilluar procedurën e pranimin në punë të një Specialisti të Prokurimit Publik, sipas Konkursit RN00013278, për pozitën: Zyrtar i Prokurimit në Zyrën e Prokurimit tek Zyra e Kryetarit të Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:
 - Ekrem Bytyqi, kryesues;
 - Esat Hoti, zëvendësues;
 - Lendrit Qeli, anëtar;
 - Qëndresa Kryeziu, zëvendësuese;
 - Agron Thaqi, anëtar;
 - Shqipe Tara, zëvendësuese;
 - Isak Hoti, anëtar;
 - Vjollca Berisha, zëvendësuese;
 - Mirsad Shala, anëtar;
 - Artan Asllani, zëvendësues.
- Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset komisioni.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Komisioni,
- Udhëheqësi i Personelit, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3985 Nr. i faq./Br.str/No.pg 102

Data/Datum/Date 15/3/24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr. 03/L-040, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

1. **OBLIGOHET** Drejtoria për Buxhet dhe Financa, që znj. Leonora Koçinaj, e sistemuar në punët dhe detyrat e punës, si: Zyrtare për Mirëqenie Sociale në Qendrën për Punë Sociale në Rahovec, ta përfshijë në listën e pagave, me pagë të plotë mujore nga data 17.03.2024.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Leonora Koçinaj,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Njësia e Përsoneelit, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine / Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRZEDSIĘDZIKI OPŠCINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësi Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3987 Nr. i faq./Br.str./No.pg 102
Data/Datumi/Date 15 / 3 / 24
RAHOVEC / ORAHOVAC

